



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

Nr. 74 Prot.

Tiranë, 15 / 06 / 2020

VENDIM

Nr. 4 datë 15 / 06 / 2020

**“PËR MIRATIMIN PËR PËRFSHIRJEN NË PAKETËN LEHTËSUESE
FINANCIARE TË PROPOZUAR NGA EUROCONTROL PËR SHKAK TË
SITUATËS SË KRIJUAR NGA COVID-19,**

Në zbatim të Konventës Ndërkombëtare të Eurokontrol lidhur me Bashkëpunimin për Masat e Sigurisë të Fluturimit, datë 13.12.1960, nenit 8 dhe 9 të Ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 5 dhe 6 të Ligjit nr.10233, datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, i ndryshuar, si dhe duke konsideruar parashtrimet e Drejtorit të Përgjithshëm të Eurocontrol në dokumentat Ref: DGD20_0296 “Loan facility: Confirmation of Member State participation and approval” dhe “Letter of Agreement and Instruction – COVID-19 Financial Relief Package”, Këshilli Drejtues me propozim të Drejtorit Ekzekutiv të Autoritetit të Aviacionit Civil,

VENDOSI:

1. Miratimin e propozimit për përfshirjen e AAC-së në paketën lehtësuese financiare të Eurocontrol nëpërmjet kredimarrjes, për rikuperimin e të ardhurave të munguara për periudhën 4 mujore Mars – Qershor 2020, deri në masën 51% të të ardhurave të parashikuara për këtë periudhë”.
2. Autoriteti i Aviacionit Civil të marrë masat që të nënshkruajë me Albcontrol Sh.A marrëveshjen me instruksionet përkatëse të disbursimit dhe ripagimit të kredisë sipas pjesës takuese të secilës palë.
3. Ngarkohet Drejtori Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil të kërkojë miratimin e Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ndërmarrë hapat e mëtejshëm për miratimin përfundimtar të këtij propozimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT DREJTUES

Dritan Gjonbalaj

Dritan
Gjonbala

Digitally signed by
Dritan Gjonbalaj
Date: 2020.06.15
09:08:51 +02'00'